

Asnjë fëmijë i Europës
nuk duhet të jetë
pa shtetësi

Studim për Shqipërinë

Maj 2015



European
Network on
Statelessness



Rrjeti Evropian për Pashtetësisë (ENS) është një rrjet i OJQ-ve, nismave akademike dhe ekspertëve individualë, i angazhuar për adresimin e pashtetësisë në Evropë - aktualisht me 100 anëtarë në më shumë se 30 vende evropiane. Si pjesë e fushatës së saj aktuale "Asnjë nga Fëmijët Evropianë nuk duhet të jetë pa shtetësi", ENS po drejton punën kërkimore në 8 (tetë) vende evropiane. Duke shqyrtuar legjislacionin kombëtar dhe zbatimin e tij në praktikë - përfshirë mangësitë dhe praktikën e mira – ky kërkim synon të promovojë masat që sigurojnë se fëmijët e lindur në Evropë ose nga prindër evropianë që jetojnë jashtë rajonit, i realizojnë të drejtat e tyre për shtetësi.

© Rrjeti European i Pashtetësisë. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky punim dhe seksionet më poshtë mund të shpërndahen dhe riprodhohen pa nevojën e lejes formale, për qëllime kërkimore jo tregtare, studime private, raportim lajmesh dhe trajnime, me kusht që materiali ti atribuohet saktë autorit dhe mbajtësit të kopirajtit.

Ky punim është porositur nga Rrjeti European i Pashtetësisë, (në anglisht European Network on Statelessness, ENS), një aleancë e shoqërisë civile me 100 anëtarë në mbi 30 vende, i përkushtuar ndaj adresimit të pashtetësisë në Europë. Midis objektivave të tjera, ENS lobon (mbron), për të drejtën e shtetësisë për të gjithë individët. Ky punim është pjesë e një serie punimesh që janë përgatitur në mbështetje të fushatës së ENS “Asnjë prej fëmijëve të Europës nuk duhet të jetë pa shtetësi”, i cili nisi në Nëntor 2014. ENS dëshiron të bëjë më dije, vlerësimin për mbështetjen bujare të marrë nga Sigrid Rausing Trust, dhe Zyra e Komisionerit për refugjatët pranë Kombeve të bashkuara, përta i përket kësaj fushate.

Puna kërkimore dhe shkrimi e këtij punimi është bërë nga Rajmonda Bozo, Drejtore Ekzekutive, Vangjel Kosta, Avokat, dhe Anisa Metalla, Avokate e Tirana Legal Aid Society (TLAS) dhe anëtare e ENS.

Rrjeti European i pashtetësisë
Club Union House, 253-254 Upper Street
London, N1 1RY
United Kingdom
Charity Number 1158414

info@statelessness.eu
www.statelessness.eu

Për më tepër informacion mbi ENS, aktivitetet dhe propozimet për punë kërkimore, ose bashkëpunime të tjera, kontaktoni drejtorin e ENS, Chris Nash në adresën chris.nash@statelessness.eu.



The Institute on Statelessness and Inclusion is an Expert Partner for the ENS Campaign “None of Europe’s Children should be stateless”. This working paper series on Ending Childhood Statelessness was created using a research template designed by the Institute, and extensive comments and input were provided for all papers by Dr Laura van Waas, Co-Director.

Përmbajtja

Hyrje

1. Shtetësia në Kontekstin Vendas
2. Dhënia e shtetësisë fëmijëve që ndryshe mbeten pa shtetësi
3. Prandalimi i pashtetësisë së fëmijëve në kontekst më të gjerë
4. Regjistrimi i lindjes dhe pashtetësia

Hyrje

Kuadri Legjislativ shiptar u ka përmirësuar dukshëm vitet e fundit, por referuar çështjeve të pashtetësisë ai ende nuk përputhet plotësisht me standartet ndërkombëtare, veçanërisht në mbrojtjen e situatës së mbetjes pa shtetësi të fëmijëve. Legjislacionit shqiptar i mungojnë iniciativat dhe aktet e duhura ligjore, të cilat pengojnë zbatimin e një procesi të nevojshëm nga ana e institucioneve përkatëse. Baza aktuale ligjore e cila lidhet me pashtetësinë, ende nuk e përfshin tërësisht kuadrin ligjor ndërkombëtar, i cili kryesisht përfaqësohet vetëm nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria¹, e si pasojë ka boshllëqe dhe pasaktësi në legjislacionin vendas të cilat duhet të adresohen për të arritur përputhjen me standartet ndërkombëtare dhe Europiane në fushën e pashtetësisë së fëmijëve, në mënyrë që të kënaqen kërkesat e nevojshme për marrëveshjen e aderimit Europian².

TLAS si një Organizatë jo Qeveritare e specializuar në çështjet e regjistrimit civil, ka identifikuar disa dobësi administrative dhe institucionale, të cilat e bëjnë më të vështirë adaptimin dhe përdorimin e standarteve të domosdoshme ndërkombëtare sa i takon çështjes së pashtetësisë. Ky studim është një përpjekje serioze për të identifikuar boshllëqet ligjore veçanërisht në çështjen e pashtetësisë së fëmijëve në Shqipëri, në mënyrë që të adresohen në organet shqiptare legjislative dhe ekzekutive.

SEKSIONI I: Shtetësia në Kontekstin vendas

1.1 Detyrimet Ndërkombëtare

Shteti Shqiptar ka aderuar në “Konventën për statusin e personave pa shtetësi” nëpërmjet ligjit Nr .9057, datë 24.4.2003 “Per Aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventen Per Statusin e Personave pa Shtetësi”. Po ashtu në vitin 2003 ka aderuar në “Konventën për Reduktimin e Pashtetësisë”, gjithashtu në 2002 ka ratifikuar “Konventën Europiane për Shtetësinë”.

Po ashtu shteti ynë ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës në vitin 1991, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike në vitin 1991, Konventën Ndërkombëtare për zhdukjen e të Gjitha Formave të Dallimit Racor në vitin 1993, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave në vitin 1993 dhe gjithashtu Konventën e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” në vitin 2012.

Bazuar në legjislacionin shqiptar, konkretisht nenet 116 dhe 117 të Kushtetutës së R. së Shqipërisë parashikohet;

“Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- a) Kushtetuta;*
- b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;*
- c) ligjet;*
- ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.*

Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj, shpallen dhe botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet. Shpallja dhe botimi i marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare bëhet sipas ligjit.”

Këto akte ndërkombëtare konsiderohen pjesë e legjislacionit të brëndshëm të Republikës së Shqipërisë dhe janë drejtëpërdrejtë të zbatueshme.

Nuk rezulton që shteti shqiptar të jetë palë në konventën e vitit 2006 të Këshillit të Europës për “Shmangien e e Pashtetësisë në Kontekstin e Zhvillimit Shtetëror”.

Referuar legjislacionit në tërësi dhe detyrimeve që burojnë prej akteve ndërkombëtare të ratifikuara si më sipër përmendur, nuk rezulton që Shqipëria të ketë shprehur ndonjë rezervë lidhur me të drejtën e fëmijëve për të patur një shtetësi. Ligji Shqiptar i përqafton të dy konceptet e fitimit të shtetësisë, jus soli dhe jus sanguinis, pra për shkak të lindjes në territorin shqiptar dhe për shkak të lidhjes së gjakut. Në sejcililin prej rasteve është parashikuar procedura që duhet ndjekur për të fituar shtetësinë. Ajo që vlen të përmendet është se problemet me regjistrimin civil të fëmijëve, drejtëpërsërejt kanë ndikuar në mohimin e të

¹ Addressing Statelessness in Albania as a protection tool, Gap Analyses Framework, UNHCR Albania Report 2013

² Mapping Statelessness Report, Common outline for Albania, 2011.

Në strategjinë e tij të zhvillimit të vitit 2013, Komisioni Europian identifikoi fuqizimin e të drejtave të njeriut duke përfshirë Romët dhe masat kundër diskriminimit, si një nga pesë prioritetet kyçe për hapjen e negociatave të zgjerimit me Shqipërinë.

* <http://eudelegationalbania.ordpress.com/2014/02/20/eu-albania-policy-dialogue-seminar-on-inclusion-of-roma-and-egyptian-communities/>

drejtës për të patur një shtetësi në rastet e fëmijëve që mbeten të parregjistruar në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve.

1.2 Kuadri Legjislativ Shtetëror

Rregullat për fitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare rregullohen nëpërmjet ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar me ligjin nr. 8442, datë 21.1.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”. Pra sikurëse mund të shikohet qartë ndryshimet e fundit ligjore kanë ndodhur në vitin 1999.

Në zbatim të dispozitave ligjore që përcaktojnë rregullat dhe kriteret për fitimin, lënien dhe rifitimin e shtetësisë Shqiptare kanë dalë në zbatim disa akte nën-ligjore të cilat përcaktojnë rregullat, afatet, dokumentat dhe autoritetet kompetente për shqyrtimin e këtyre kërkesave, që janë:

UDHËZIM i përbashkët nr. 6252 datë 10.12.2001 dhe nr. 3583 datë 27.11.2001 i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Rendit Publik “Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rifitimin, dhe heqjen dorë nga shtetësia Shqiptare”, i ndryshuar me UDHËZIMIN e përbashkët nr. 10452/2 datë 26.09.2007 dhe nr. 5212/2 datë 17.09.2007 i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme;

VENDIM nr. 554, datë 3.7.2013 “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës”;

UDHËZIM i përbashkët nr. 4573/3, datë 12.7.2013 “Për procedurat, afatet dhe dokumentacionin e kërkesave për njohje të shtetësisë Shqiptare, shqyrtimin e tyre, si dhe formën dhe mënyrat e plotësimit të kërkesës për fitimin e shtetësisë Shqiptare nga personat me origjinë shqiptare”.

Fitimi, humbja apo heqja dorë nga shtetësia shqiptare bëhen me dekret të Presidentit të Republikës. Personi duhet më parë të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet për çdo rast dhe është Ministria e Brendshme³ autoriteti që kontrollon dhe bën verifikimet mbi dokumentacionin e paraqitur e më pas vendos për t’ja kaluar këtë kërkesë Presidentit për dekretim. Vendimi për mos t’ja kaluar dokumentacionin Presidentit është i kundërshtueshëm gjyqësisht dhe Gjykatë kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (neni 19/3 I ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar)⁴

Ligjet ekzistuese nuk i lejojnë subjekteve të interesuar mundësinë për të kundërshtuar dekretin e Presidentit për dhënien apo heqjen e shtetësisë.

Megjithatë përmes vendimit nr. 5193 datë 23.12.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka gjykuar një çështje e cila me dekret të Presidentit kishte lejuar “lënien e shtetësisë shqiptare për S.N.”. Kjo çështje tregon që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë pranuar parimin Kushtetues “për një gjykim të drejtë” dhe të drejtën “për të apeluar” për të vënë në vend mungesën e një parashikimi ligjor për të apeluar vendimarrjen sa takon çështjeve të pashtetësisë.

Përkufizimin për personin pa shtetësi e gjejmë në ligjin Nr. 108/2013 “Për të Huajt” konkretisht neni 3/2 I cili përcakton: “Person pa shtetësi” është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti”.

Ligji i mëparshëm nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, tashmë i shfuqizuar, jepte këtë përkufizim për personin pa shtetësi: “Person pa shtetësi” është çdo person, të cilit, sipas konventës për statusin e personave pa shtetësi, nuk mund t’i provohet shtetësia e ndonjë shteti”. Duhet theksuar se ligji aktual nr. 108/2013 “Për të Huajt” është përafruar me të gjitha rregulloret dhe direktivat e Parlamentit Europian dhe të Këshillit.

1.3 Studimet ekzistuese, të dhënat dhe njohuritë mbi pashtetësinë (e fëmijëve)

Prej vitesh në Shqipëri ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë problemi i fëmijëve të paregjistruar në zyrën e gjendjes civile. Arsytet pse ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë ky problem janë të ndryshme, mirëpo efektet që ka krijuar janë tepër komplekse që fillojnë nga mohimi i të drejtave themelore të fëmijës, deri tek mohimi i të drejtës për të patur një shtetësi e deri tek mohimi i një kujdesi tërësor e kompleks që duhet t’i garantohet fëmijëve si subjekt që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti⁵. Ky problem nuk mund të thuhet se ka qënë i panjohur për shtetin, edhe pse qasja më e madhe ndaj tij është bërë prej Organizatave jo Fitimprurëse.

Edhe pse ndër vite është punuar shumë nëpërmjet përmirësimeve të legjislacionit në këtë fushë, çështja e fëmijëve të paregjistruar nuk është trajtuar si një çështje veçanërisht e lidhur me pashtetësinë.

Për të dhëna statistikore zyrtare mund t’i referohemi Institutit të Statistikave të Republikës së Shqipërisë. Të dhënat më të fundit i kemi nga censusi i përgjithshëm i popullsisë i realizuar në vitin 2011, nga ku në një grupim të veçantë janë mbledhur të dhëna bashkarisht për shtetësitë dhe gjininë. Nga kjo kategori re-

³ Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar, duke qënë i hershëm i Referohet Ministrisë së Brendshme si “Ministria e Rendit Publik” duke j’u referuar emertmit të mëparshëm të institucionit.

⁴ Neni 19/3 “Vendimi për bërjen ose jo të kërkesës nga ana e Ministrisë së Rendit Publik i behet e njohur subjekteve të interesuara, të cilat, në rast se nuk janë dakord me përmbajtjen e tij, mund të ngrenë padi në gjykatën e rrethit Tirane”.

⁵ Neni 54/1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Ligj, Nr.8417, Dt.Aktit:21.10.1998, Dt.Miratimit:21.10.1998, Flet.Zyrtare Nr.28, Faqe:1073 I ndryshuar “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

zulton edhe kategoria e personave pa shtetësi të cilët rezultojnë të jenë 7,443 persona⁶. Asnje të dhënë tjetër nuk marim nga ky numër përveç ndarjes gender, pra sa femra dhe sa meshkuj. Nuk ka të dhëna zyrtare se sa nga këta persona pa shtetësi janë fëmijë, po ashtu nuk ka të dhëna se cilat janë arsyet e mbetjes pa shtetësi.

Rregjistrimi i fëmijëve në Rrepublicën e Shqipërisë rregullohet nga ligji nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjëndjen civile”. Ky ligj përcakton prioritarë përgjegjësi në prindërore në realizimin e të drejtës së fëmijës për t’u regjistruar dhe, në rast të dështimit të kësaj procedure ngarkon organet shtetërore të zëvendësojnë këtë përgjegjësi të prindit për rregjistrimin e fëmijës.

Kjo procedurë e lidhjes së rregjistrimit të fëmijës edhe me rregjistrimin e prindit (kryesisht amësisë) ka shkaktuar problemet më të mëdha të mungesës së rregjistrimit, pasi nëse prindi, për shkak të paplotësisë së dokumentave nuk mund të vërtetojë lidhjen prindërore me fëmijën, nuk mundet të realizojë vetë procesin e rregjistrimit të fëmijës në rregjistrat e gjëndjes civile.

1.4 Subjektet e interesuara

Shtetësia është concept i lidhur ngushtësisht me rregjistrimin në rregjistrat e gjëndjes civile. Për rrjedhojë, çështja e fëmijëve të paregjistruar të cilëve drejtëpërsëdrejti ju mohet edhe e drejta për të patur një shtetësi ka qënë subjekt i vazhdueshëm vëmendjeje, veçanërisht TLAS ka një eksperiencë të konsideruar në çështje duke qënë edhe iniciuese për ndryshimin, plotësimin e përmirësimin e kuadrit ligjor në këtë fushë. TLAS përfaqëson një organizatë jofitimprurëse në vend dhe në drejtimin e kësaj kauze ka patur në rrugen e saj disa partnerë të rëndësishëm siç janë Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë apo ajo e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Nuk mund të thuhet se kjo çështje është trajtuar veçanërisht si një kauzë prioritarë nga ndonjë funksionar shtetëror, përkundrazi ndër vite është dashur të bëhet një punë e madhe advokuese për të sensibilizuar organet shtetërore mbi rëndësinë e këtij problemi madhor. Po ashtu vlen të theksohet se ndihma juridike e ofruar ndër vite nga TLAS për çështjet e regjistrimit civil, është përballuar në kuadër të projekteve të ndryshme të financuara nga donatorë të huaj.

Shteti nuk ofron statistika periodike mbi këtë çështje edhe pse një gje e tillë inkurajohet të bëhet nga legjislacioni. Për shembull nga puna e TLAS vijnë të dhëna mjaft domethënëse. Gjatë vitit 2012 TLAS ka punuar në 4 nga qytetet kryesore në Shqipëri nga ku konstatohet se janë regjistruar në zyrën e gjëndjes civile, si pasojë kanë fituar shtetësinë shqiptare 282 fëmijë nga të cilët 60% i përkasim komunitetit rom, 180 prej këtyre rasteve janë fëmijë të cilët kanë lindur jashtë territorit të Shqipërisë dhe për 26 prej rasteve është dashur të ndiqet procedurë gjyqësore për të vërtetuar faktin e lindjes në mënyrë që të bëhet regjistrimi i tyre e më pas automatikisht përfitimi i shtetësisë shqiptare.

Referuar asaj që u përmend më sipër nuk mund të themi se organet shtetërore vendase kanë ndërgjegjësimin e duhur veçanërisht mbi çështjen e pashtetësisë së fëmijëve dukë qenë se bazuar në ligj nuk ka një institucion shtetëror i cili duhet të jetë drejtëpërdrejtë i përfshirë në çështje. Edhe statistikat zyrtare, nuk tregojnë një shifër të veçantë për fëmijët pa shtetësi në Shqipëri. Nga studimet aktuale⁷ të kryera nga INSTAT dhe organet jo-qeveritare nuk rezulton gjithashtu të ketë një përpjekje për të identifikuar numrin e fëmijëve pa shtetësi për këtë shkak. Duke qënë se fitimi i shtetësisë realizohet bashkë me procesin e regjistrimit civil, kjo është arsyeja pse numri i fëmijëve të regjistruar dhe shifrat e dhëna në këtë studim për fëmijët e regjistruar, do të jepen për të kuptuar indirekt se si ka qënë situata e fëmijëve pa shtetësi në vend.

Autoriteti shtetëror qëmerret me të huajt (dhe personat pa shtetësi ose që nuk vërtetojnë shtetësinë e ndonjë shteti tjetër) është një strukturë e posaçme për Kufirin dhe Migracionin. Ndërsa autoriteti qendror që merët më çështjet e refugjatëve, kërkesave për azil dhe bashkarisht me çështjet e fitimit, rifitimit dhe lënies së shtetësisë shqiptare është Drejtoria për Shtetësitë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme. Sidoqoftë, këto institucione nuk kanë autoritet për të njohur personat pa shtetësi që lindin brenda territorit të Shqipërisë.

Nga intervistat e realizuara për shkak të këtij studimi njësitë e përmendura më sipër nuk kanë të dhëna lidhur me shkaqet e mbetjes së fëmijëve pa shtetësi dhe numrin e fëmijëve të prekur pasi kjo nuk trajtohet si një çështje e veçantë në objektin e veprimtarisë së tyre.

⁶ <http://www.instat.gov.al/census/census-2011/t%C3%AB-dh%C3%ABnat-e-census-2011.aspx>

⁷ UNHCR, “Mapping Statelessness Report, Common outline for Albania, 2011” and “Gap Analyzes Framework, in Statelessness in Albania, 2013”;

*Tirana Legal Aid Society Assessment of feasibility for the electronic registration of child births in Albania, 2013

*National Union of Roma – Amarodrom data provided in 2010

*2011: <http://census.al/Resources/Data/Census2011/CensusQuestionnaire.pdf>, Question 39

*Centre for Economic and Social Studies (CESS), Mapping Roma Children in Albania, 2011

SEKSIONI 2: Dhënia e shtetësisë fëmijëve që ndryshe mbeten pa shtetësi

2.1 Rregullat e përgjithshme për fitimin e shtetësisë

Sipas legjislacionit shqiptar shtetësia fitohet bazuar bashkarisht në rregullin e lidhjes së gjakut edhe në rregullin e lindjes brenda territorit të shtetit Shqiptar, pra jus sanguinis dhe jus soli.

Kushdo që lind duke pasur qofte edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare⁸. Në këtë rast personi regjistrohet menjëherë si shtetas shqiptar me të provuar lidhjen qofte me njërin prej prindërve.

Por edhe një fëmijë i lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë nga prindër me shtetësi të huaj por rezidentë të ligjshëm në shtetin shqiptar mund ta fitojë shtetësinë me pëlqimin e tyre. I vetmi kufizim në këtë rast lidhet me statusin e prindërve të cilët duhet të jenë rezidentë të ligjshëm në Shtetin Shqiptar.

Në të gjitha dispozitat e ligjit shqiptar për rregullat e fitimit të shtetësisë konstatohet dukshëm përfshirja e një mbrojtje maksimale ligjore që asnjë fëmijë mos të ketë mungesë aksesit në të drejtën për të patur një shtetësi.

Aplikimi për të përfituar shtetësinë shqiptare bëhet pasi më parë verifikohet/regjistrohet lindja e një shtetasi sipas ligjit për gjendjen civile⁹. Neni 38/1 i ligjit “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar⁹ parashikon: “Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor”.

Pra nga interpretimi i dispozitës së mësipërme, legjislacioni e njeh procesverbalin e mbajtur në një anije apo avion për të vërtetuar faktin e lindjes. Nëse procesverbali është mbajtur në mënyrë të rregullt dhe vërtetohet në mënyrë të saktë lindjen atëherë kjo lindje regjistrohet menjëherë në zyrën e gjendjes civile të shtetit shqiptar nëse avioni apo anija mbajnë përkatësisht flamurin e Shtetit Shqiptar, si pasojë lind vetiu edhe e drejta për të fituar shtetësinë shqiptare.

2.2 E drejta për të patur një shtetësi për fëmijë të lindur brenda territorit të cilët përndryshe mbeten pa shtetësi

Sikurëse u përmend edhe më sipër, edhe një fëmijë i lindur në territorin e Republikës së Shqipërisë nga prindër të huaj (të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë) mund ta fitojë shtetësinë shqiptare. Shteti duket se i ka marrë të gjitha masat që të paktën ligji të mos përmbajë asnjë dispozitë që rrit rrishtun e mbetjes së një fëmije pa shtetësi dhe në këtë aspekt nuk evidentohet asnjë dispozitë që vështirëson procesin e fitimit të shtetësisë që mund të pasojë edhe me mbetjen pa shtetësi.

Shtetasit e huaj të cilëve ju lind një fëmijë në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të paraqiten drejtëpërsëdrejti në zyrën e gjendjes civile ku ata kanë vendbanimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ata mjafton të disponojnë dokumentat që provojnë rezidencën në Republikën e Shqipërisë dhe fëmija regjistrohet menjëherë dhe fiton shtetësinë Shqiptare.

2.3 E drejta për të patur një shtetësi për fëmijë të lindur brenda territorit, në praktikë.

Autoriteti përgjegjës i cili njeh edhe shtetësinë e një fëmije i cili përndryshe mbetet pa shtetësi është Zyra e Gjendjes Civile e vendbanimit të prindërve që e kanë lindur fëmijën ose Zyra e Gjendjes Civile e territorit ku është gjetur fëmija. Zyrat e Gjendjes Civile janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile e cila është në Strukturën e Ministrisë së Brendshme. Një nga përbërësit e gjendes civile është shtetësia, e cila shënohet nga punonjësi së bashku me të dhënat e tjera të identitetit të fëmijës pas regjistrimit të tij.

E drejta për të patur një shtetësi nuk është një e drejtë për të cilën institucionet shtetërore apo Organizata të ndryshme kanë advokuar apo advokojnë në vazhdimësi. Çështja për të cilën ka patur një ndjeshmëri të lartë dhe vazhdimisht është advokuar dhe si pasojë ka patur dhe ndryshime në legjislacion duke patur si inisiatore kryesisht shoqërinë civile, është çështja e fëmijëve të paregjistruar ku si pasojë e mosregjistrimit një nga të drejtat e mohuara është edhe e drejta

⁸ Neni 7 Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar me ligjin nr. 8442, datë 21.1.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”.

⁹ Ligj nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar.

për të patur një shtetësi. Edhe ndihma juridike në çështjet civile në vend është ofruar dhe vazhdon të ofrohet kryesisht prej organizatave jofitimprurëse. Edhe pse ka një komision shtetëror për ofrimin e ndihmës juridike, praktikisht ky institucion deri më tani nuk ka qënë efektiv në mbulimin me ndihmë juridike falas të nevojës që rezulton të kenë komunitetet në nëvoje. Kështu rrjedhimisht edhe në këtë drejtim nuk mund të themi se shteti ofron një bazë të qendrueshme për përfaqësimin e çështjeve të pashtetësisë. Po ashtu nga ajo që konstatohet praktikisht, edhe UNHCR në Shqipëri është kryesisht e përfshirë në çështjet e refugjatëve dhe të huajve që kërkojnë azil në Republikën e Shqipërisë.

Nga analiza e bërë në tërësi dhe prezantimi I kuadrit ligjor, rrjedhimisht kuptohet se nuk ka statistika se sa fëmijë pa shtetësi kanë lindur në Shqipëri dhe sa prej tyre e kanë patur të mundur ta fitojnë shtetësinë shqiptare osë një shtetësi tjetër. Po ashtu nuk konstatohet të ketë çështje gjyqësore për mungesë të aksesit në të drejtën për të fituar shtetësinë. Gjithsesi nga të dhënat e database të TLAS mund të pasqyrohen rastet e fëmijëve të regjistruar gjatë tre viteve të fundit të cilët rrjedhimisht si pasojë e mosregjistrimit nuk kanë patur akses në të drejtën për shtetësi, lindje të regjistruara administrativisht ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor.

2.4 E drejta për të patur një shtetësi për fëijët e lindur jashtë vendit, bazuar në ligj dhe praktikë.

Neni 7 i Ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar me ligjin nr. 8442, datë 21.1.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”, parashikon se “Kushdo qe lind duke pasur qofte edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare”.Ky parashikim nuk lidhet me statusin e të qënit prindërit të martuar apo jo. Fëmija e fiton shtetësinë shqiptare mjafton të provohet shtetësia shqiptare e njërit prind pra edhe nese ata nuk janë të martuar.

Nga parashikimi i mësipërm ligjor përfiton çdo fëmijë, i lindur brenda ose jashte vendit. Nëse fëmija ka lindur jashtë vendit nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes dhe si pasojë fitimi i shtetësisë automatikisht, realizohet duke u paraqitur prindërit pranë përfaqësive diplomatike shqiptare të vendit ku ka ndodhur lindja¹⁰.

Po ashtu nëse fëmija ka lindur jashtë vendit dhe është regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile të shtetit të huaj, prindërit të cilët janë shtetas Shqiptarë gjithashtu mund ta regjistrojnë fëmijën drejtëpërsëdrejti në Zyrën e Gjendjes Civile të vendbanimit të tyre në Shqipëri. Në këtë rast kërkohet që akti i lindjes së fëmijës të jetë në formën e kërkuar nga ligji, pra ai të jetë një akt i legalizuar që njihet nga autoritetet shtetërore shqiptare¹¹.

Mund të themi që legjislacini shqiptar është i harmonizuar me Parashikimet e bëra në konventat ndërkombëtare sa i takon rregullave të fitimit të shtetësisë (konkretisht neni 4 i Konventës për Reduktimin e Pashtetësisë si dhe neni 6 i Konventës Europiane për Shtetësinë)¹²

10 Ligj nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar neni 41 “1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja.
2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.
3. Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë, me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare, në vendin ku ka lindur. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.
4. Kur regjistrimi i lindjeve kryhet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe brenda 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.
5. Fondi për shpërblimin e përmendur në pikën 4 të këtij neni, përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe tërhiqet pranë bashkisë/njësisë bashkiake/komunës përkatëse.
6. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara, që çdo ditë të hënë, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre.
7. Njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në pikën 2 të nenit 40 të këtij ligji, në zonën që mbulojnë”.

11 Ligj nr.9060, date 8.5.2003 “Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne “Konventen per Heqjen e Kerkeses per Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare te Huaja”

12 Ligj nr. 8942, datë 19.9.2002 “Për ratifikimin e “Konventës Europiane për Shtetësinë” Neni 6 i konventës:
“Fitimi i shtetësisë
1. Çdo Shtet Pale do te parashikojë ne te drejtën e tij te brendshme qe shtetësia e tij te fitohet ex lege nga personat e mëposhtëm:
a) fëmijët, njeri nga prindërit e te cilëve mban ne momentin e lindjes se këtyre fëmijëve, shtetësinë e atij Shteti Pale, me ndonjë përjashtim qe mund te parashikohet ne te drejtën e brendshme ne lidhje me fëmijët e lindur jashtë shtetit. Lidhur me fëmijët, prindërit e te cilëve caktohen nëpërmjet njohjes, urdhri gjyqësor apo procedurave te ngjashme, çdo Shtet Pale mund te parashikojë qe fëmija te fitojë shtetësinë e tij duke ndjekur procedurën e përcaktuar nga e drejta e tij e brendshme;
b) foshnjat e gjetura ne territorin e tij, te cilat përndryshe do te ishin pa shtetësi.
2. Çdo Shtet Pale do te parashikojë ne te drejtën e tij te brendshme qe shtetësia e tij te fitohet nga fëmijët, e lindur ne territorin e tij, te cilët nuk fitojnë ne lindje një tjetër shtetësi. Kjo shtetësi do t’u jepet:
a) ne lindje ex lege; ose
b) me pas, fëmijëve qe mbeten pa shtetësi, pas një kërkesë drejtuar autoritetit përkatës, nga apo për fëmijën e interesuar, ne mënyrën e parashikuar nga e drejta e brendshme e Shtetit Pale. Një kërkesë e tille mund te behet duke u mbështetur edhe ne qëndrimin e ligjshëm dhe te vazhdueshëm ne territorin e tij për një periudhe jo me shume se pese vjet menjëherë përpara paraqitjes se kërkesës.
3. Çdo Shtet Pale do te parashikojë ne te drejtën e tij te brendshme mundësinë e natyralizimit te personave qe qëndrojnë ne mënyrë te ligjshme dhe te vazhdueshme ne territorin e tij. Ne vendosjen e kushteve për natyralizim, ai nuk do te parashikojë një periudhe qëndrimi me te gjate se dhjete vjet përpara paraqitjes se kërkesës.
4. Çdo Shtet Pale do te lehtësojë ne te drejtën e tij te brendshme fitimin e shtetësisë se tij për personat e mëposhtëm:
a) bashkëshortët e shtetasve te tij;
b) fëmijët e një prej shtetasve te tij, qe bien nen përjashtimin e nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi a;
c) fëmijët, njeri nga prindërit te te cilëve fiton apo ka fituar shtetësinë e tij;
d) fëmijët e birësuar nga një shtetas i tij ;
e) personat qe kane lindur ne territorin e tij dhe qëndrojnë aty ligjërisht dhe ne mënyrë te vazhdueshme;
f) personat qe qëndrojnë ne mënyrë te ligjshme dhe te vazhdueshme ne territorin e tij për një periudhe kohe qe fillon para moshës 18 vjeç periudhe qe përcaktohet nga e drejta e brendshme e Shtetit Pale te interesuar;
g) personat pa shtetësi dhe refugjate te njohur, qe qëndrojnë ligjërisht dhe ne mënyrë te vazhdueshme ne territorin e tij”.

Ligj nr.9059, datë 8.5.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për reduktimin e pashtetësisë”, neni 4:
“Neni 4
1. Një Shtet Kontraktues i jep shtetësinë e tij një personi, qe nuk ka lindur ne territorin e një Shteti Kontraktues i cili ndryshe do te jete pa shtetësi, nëse shtetësia e njërit prej prindërve te tij ne kohen e lindjes se personit ishte e atij shteti. Nëse prindërit e tij nuk kishin te njëjtën shtetësi ne kohen e lindjes se tij, çështja, nëse shtetësia e personit te interesuar duhet te ndjeko atë te babait ose atë te nënës, duhet te vendoset nga e drejta e brendshme e këtij Shteti Kontraktues. Shtetësia e dhënë ne përputhje me dispozitat e këtij paragrafi jepet:
a) ne lindje, nga veprimi i ligjit ose
b) ne baze te një aplikimi te paraqitur tek autoritetet përkatëse, nga ose ne emër te vete personit te interesuar, ne mënyrën e parashikuar nga e drejta e brendshme. Bazuar ne dispozitat e paragrafit 2 te këtij neni, asnjë

SEKSIONI 3: Prandalimi i pashtetësisë së fëmijëve në kontekst më të gjerë

3.1 Fëmijët e gjetur

Bazuar në nenin 8/1 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar parashikohet: “1. Një fëmijë i lindur ose i gjetur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë merr shtetësinë shqiptare në rast se ai është lindur nga prindër të panjohur, dhe si pasojë fëmija do të mbetet pa shtetësi’
Në rast se prindërit e fëmijës bëhen të njohur përpara se fëmija të ketë arritur moshën 14 vjeç, dhe ata janë me shtetësi të huaj, shtetësia shqiptare mund të hiqet me kërkesë të prindërve të njohur ligjërisht, me kusht që fëmija të mos mbetet pa shtetësi si pasojë e këtij veprimi”.

Pra sikurëse mund të shikohet legjislacioni vendas e ofron këtë garanci për fëmijët që quhen të gjetur, e që automatikisht nuk dihen apo disponohen të dhëna mbi prindërit e tij. Pra fëmija regjistrohet automatikisht si shtetas Shqiptar.

Bazuar në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar, konkretisht në nenin 49 parashikohet: “Dokumentet bazë të personave të gjetur :

1. Fëmija me prindër të panjohur prezumohet i lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor.
 2. Fëmija me prindër të panjohur pajiset me procesverbal nga organet përkatëse të rendit publik dhe raport mjekësor, të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur.
 3. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose, kryesisht, me miratimin e kryetarit të bashkisë/ njësisë bashkiake/komunës, ku është gjetur fëmija, atij i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindëresh imagjinare, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhor, ose me vërtetimin ligjërisht të prindërve.
 4. Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për fëmijët me prindër të panjohur, që kanë humbur kujtesën ose janë të paaftë mendërisht dhe që nuk identifikohen. Fëmijës së gjetur mund t’i ndryshojë kjo gjendje, në rastet kur i kthehet kujtesa, kur shërohet mendërisht ose identifikohet me një mënyrë tjetër.
 5. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, fëmija i gjetur regjistrohet në vendin, ku vendoset për jetesë, me përjashtim të të gjeturit madhor, që flet vetëm gjuhë të huaj e që regjistrohet si person pa shtetësi.
 6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personin madhor, që ka humbur kujtesën, që është i paaftë mendërisht e që nuk i dihen prindërit, është gjetur me prindër të vdekur, të paidentifikuar, përveç rastit, kur ky person flet vetëm gjuhë të huaj. Në këtë rast ai trajtohet si person pa shtetësi”.
- Nga sa vihet re nga parshikimi ligjor i mësipërm, duket që nuk ka asnjë pengesë sa i takon fëmijëve që konsiderohen të gjetur në territorin shqiptar duke qënë në harmoni edhe me parashikimet e konventave¹³, ata mund t’a fitojnë veti shtetësinë shqiptare duke konsideruar vendin e gjetjes si vendin e fitimit të Shtetësisë, por kjo me parakushtin e rëndësishëm të regjistrimit fillimisht.

Ligji Shqiptar sa i takon procesit të regjistrimit të një fëmije në zyrën e gjendjes civile kërkon dy elemente kryesore, së pari një dokument të vlefshëm që vërteton lindjen dhe së dyti personin e autorizuar për të bërë deklarinimin e lindjes.

Për shkak të problemeve ndër vite që kanë ekzistuar lidhur me regjistrimin civil në shqipëri, dispozita e mësipërme është përdorur për të zgjidhur rastet e disa fëmijëve të paregjistruar të cilët ishin pa kujdes prindëror e për të cilët nuk disponohej një dokument i vlefshëm lindjeje. Në këto kushte shumë fëmijë janë regjistruar si fëmijë të gjetur dhe automatikisht kanë fituar shtetësinë shqiptare. Më pas janë ndjekur procedura gjyqësore për t’i caktuar fëmijëve një kujdestar ligjor¹⁴.

Pamundësia për të regjistruar fëmijët të cilët nuk dispononin kujdes prindëror e në të njejtën kohë nuk ishin të regjistruar, kishte krijuar një problem mjaft të madh për një kategori personash të cilët për vite me radhë e kishin të pamundur të regjistroheshin drejtëpërsëdrejti në zyrën e gjendjes civile. Kjo dispozitë është përdorur si një zgjidhje e drejtë dhe e menjëhershme për regjistrimin e fëmijëve dhe si pasojë reduktimin e pashtetësisë mes kësaj kategorie.

Regjistrimi si fëmijë i gjetur (sipas procedurës së parashikuar në nenin 49 të sipërcituar) kërkon koordinimin e tre institucioneve që janë Njësia Bashkiake ose Komuna ku është gjetur (ose jeton fëmija), Qendra Shëndetsore e zonës si dhe Zyra e Gjendjes Civile. Këto tre institucione janë të detyruar t;I evidentojnë raste aplikim nuk refuzohet.

2. Një Shtet Kontraktues mund ta kushtëzojë dhënien e shtetësisë se tij ne përputhje me dispozitat e paragrafit 1 te këtij neni me një ose me shume prej kushteve te mëposhtme:

a) qe aplikimi te jete paraqitur përpara se aplikanti te ketë arritur një moshe, qe është jo me pak se 23 vjeç, te caktuar nga Shteti Kontraktues;

b) qe personi i interesuar te ketë banuar zakonisht ne territorin e Shtetit Kontraktues për një periudhe qe te mos i kaloje tre vjet qe i paraprin menjëherë paraqitjes se aplikimit, siç mund te caktohet nga ai shtet;

c) qe personi i interesuar te mos ketë qene dënuar për një vepër penale kundër sigurisë kombëtare;

d) qe personi i interesuar te ketë qene gjithmonë pa shtetësi”.

13 Konventën për reduktimin e pashtetësisë dhe Konventën Europiane për Shtetësinë.

14 Udhëzim nr.7, datë 10.1.2012 “Për miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve, që do të plotësohen nga përfaqësues të policisë së shtetit dhe të bashkive/njësisë bashkiake/komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile”.

të tilla dhe në bashëkpunim me njëri-tjetrin të bëjnë të mundur procedurën e regjistrimit të fëmijës. Konkretisht Punonjësi i rendit të Njesisë Bashkiake apo komunës është i detyruar të sjellë fëmijën dhe personat që e shqoërojnë, Qendra Shëndetsore duhet të pajisë fëmijën me raport mjeksor nga ku përcaktohet gjinia dhe mosha e përafërt e tij, dhe së bashku me punonjësin e zyrës së gjendjes civile mbajnë një procesverbal i cili shoqërohet më pas me regjistrimin e fëmijës.

3.2 Birësimi

Në ligjin shqiptar birësimi konsiderohet si një mënyrë fitimi shtetësie¹⁵. Sipas ligjit të brendshëm nëse dy shtetas shqiptarë birësojnë një fëmijë, edhe nëse ai është i huaj apo pa shtetësi, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Nuk ka informacion për raste në praktikë nëse fëmija e humbet apo jo shtetësinë e vendit tjetër (kjo varet nga kuadri legjislativ i vendit të shtetësisë), rëndësi ka të theksohet se ligji shqiptar garanton aksesin e fëmijës në shtetësi nëpërmjet birësimit.

Po ashtu duhet theksuar se ky nen në paragrafin e dytë të tij, thekson se shtetësinë shqiptare fëmija e fiton edhe kur njëri prej prindërve është shtetas shqiptar me kusht që të dy të jenë rezidentë në Republikën e Shqipërisë, e po ashtu në çdo rast tjetër mjafton që fëmija të mos mbetet pa shtetësi. Pra në këtë rast bëhet një prezumim që e garanton situatën një e pashtetësie të mundëshme për çdo fëmijë të birësuar.

Nga ana tjetër referuar Kodit Shqiptar të Familjës birësimi është i parevokueshëm¹⁶, pra nëse një fëmijë e fiton shtetësinë nëpërmjet birësimit ai nuk e humbet atë për shkak të revokimit apo anulimit të birësimit, pasi këto koncepte legjislacioni ynë nuk i përqafon. Është e rëndësishme të theksohet se nga birësimi ndërventas asnjë fëmijë nuk mund të mbesë pa shtetësi.

Pas vendimit gjyqësor që lejon birësimin e fëmijës ai regjistrohet automatikisht në gjendjen familjare të prindërve birësues dhe si pasojë fiton automatikisht shtetësinë, pra nuk është e nevojshme që prindërit të ndjekin një procedurë të veçantë për fëmijën që birësojnë për aplikim për shtetësi.

3.3 Surrogacia

Në legjislationin familjar shqiptar koncepti i surrogacisë dhe nënës surrogate, duket se është zhvilluar më tepër në doktrinën e së drejtës dhe nuk ka një zbërthim konkret në Kodin e Familjes.

Termi “surrogaci”, përmendet shkarazi në nenin 261 të Kodit të Familjes¹⁷ i cili flet për birësimin surrogativ dhe të referon në një tjetër ligj që është ai “Për Shëndetin Riprodhues”. Ky nen garanton hipotetikisht që edhe në rastet e një birësimi surrogativ zbatohen rregullat e përgjithshme të birësimit.

Por, edhe në ligjin specifik për birësimet nuk ka një rregullim të veçantë për birësimin surrogativ¹⁸. Po ashtu edhe ligji për shëndetin riprodhues nuk e zhvillon konceptin e surrogacisë dhe procedurën që ndiqet në këto raste. Ky ligj thjesht e përmend në një dispozitë të fundit procesin e birësimit surrogativ por parashikon që kjo procedurë do të rregullohet me akte nënligjore¹⁹. Nuk evidentohen akte nënligjore në këtë drejtim.

3.4 Humbja e shtetësisë

Bazuar në ligj, një i mitur mund ta humbasë shtetësinë shqiptare kur të dy prindërit e tij meren vesh që ta lënë shtetësinë shqiptare²⁰. Ky parashikom ligjor vlen edhe në rastet kur mungon pëlqimi i njërit prind, pra fëmija mund ta humbasë shtetësinë shqiptare nëse vlerësohet që kjo është në interesin më të lartë të tij.

15 Neni 12 Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar me ligjin nr. 8442, datë 21.1.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”.

16 Ligji nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes” neni 258, Efektet e birësimit

“Birësimi i prodhon efektet e tij nga data që vendimi merr formë të prere. Birësimi është i parevokueshëm.

Gjykata i dërgon vendimin e formës së prere për regjistrim zyrës së gjendjes civile, ku ka regjistrin themeltar birësuesi.

Marrëdhëniet ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit”.

17 Ligji nr.9062, datë 8.5.2003 Kodi i Familjes, neni 261 “Për birësimin surrogativ, të parashikuar në ligjin nr.8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”, zbatohen të njëjtat kritere dhe procedura për birësimin, sipas këtij Kodi dhe legjislationit përkatës”

18 Ligj nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit” i ndryshuar.

19 Ligj nr. 8876, datë 04.04.2002 “Për Shëndetin Riprodhues” i ndryshuar, neni 43 “Ministri i Shëndetësisë detyrohet që të nxjerrë akte të veçanta për të përcaktuar specifikimet lidhur me:

a) inseminimin artificial;

b) teknikat e riprodhimit të asistuar;

c) adoptimin surrogativ”.

20 Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar me ligjin nr. 8442, datë 21.1.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”, neni 16 “Për të miturit shtetësia shqiptare mbaron kur të dy prindërit, të cilët, nga ana e tyre, kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, merren vesh që edhe fëmija e tyre ta lërë shtetësinë shqiptare.

Edhe kur njëri prej prindërve nuk është dakord që fëmija të humbasë shtetësinë shqiptare, fëmijës mund t’i hiqet shtetësia, nëse se çmohet se një gjë e tillë është në dobi të fëmijës dhe nëse fëmija ka apo do të marrë një shtetësi tjetër.

Fëmija i mitur e humbet shtetësinë shqiptare kur birësohet nga prindër të huaj dhe fiton, me këtë rast, një shtetësi të re”.

Edhe pse shqyrtimi i kërkesës ka karakter kryesisht formal, asnjë kërkesë për lënien e shtetësisë shqiptare nuk miratohet nëse shtetasi nuk paraqet garancinë për fitimin e një shtetësie të një shteti tjetër. Pra edhe nëse nuk ekzistojnë mekanizmat e vlerësimit nëse lënia e shtetësisë shqiptare është në interesin më të lartë të të miturit, asnjë kërkesë për lënien e shtetësisë nuk mund të miratohet pa u garantuar më parë autoritetet që fëmija nuk do të mbesë pa shtetësi.

Po ashtu një tjetër rast kur i mituri e humbet shtetësinë shqiptare automatikisht është kur ai birësohet nga shtetas të huaj. Nuk ka informacion nëse i mituri e humbet automatikisht shtetësinë shqiptare, apo formalisht duhet të paraqitet një kërkesë pranë autoriteteve. Kjo varet edhe nga legjislacioni i vendit ku birësohet fëmija. Ligji shqiptar nuk është pengues në këtë drejtim, duke qënë se Shteti Shqiptar lejon edhe dyshtetësinë.

Përfundimisht ajo që vihet re është që nuk ka një praktikë të unifikuar lidhur me kërkesat për lënien e shtetësisë shqiptare në rastet e të miturve në dy aspekte; së pari nuk evidentohen raste se si shteti ushtron kontroll nëse kërkesa për lënien e shtetësisë është në interesin më të lartë të të miturit dhe së dyti nuk ka një praktikë të unifikuar se si veprohet me kërkesat për lënien e shtetësisë shqiptare për të miturit që birësohen nga shtetas të huaj. Në të dy këto drejtime ka vend për ndryshime ligjore.

3.5 Natyralizimi i lehtësuar

Gjatë këtij studimi është evidentuar se nga autoritet përkatëse (Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme) nuk ka të dhëna statistikore të veçanta mbi personat pa shtetësi. Sikurëse u përmend edhe më sipër për numrin e personave pa shtetësi i referohemi censusit të fundit të popullsisë nga të dhënat e të cilat kanë rezultuar 7443 persona pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nuk ka të dhëna të përditësuara sa është ky numër aktualisht po ashtu nuk ka të dhëna se cilat janë arsyet e mbetjes së këtyre personave pa shtetësi. Nuk ka të dhëna të përditësuara për këtë çështje që nga koha e censusit, dhe po ashtu nuk ka të dhëna të cilat shpjegojnë se pse këta persona kanë mbetur pa shtetësi. Nga intervistat e zhvilluara²¹ rezulton se numri i treguar i personave pa shtetësi konsiston në individë të cilët e kanë vetëdeklaruar pashtetësinë e tyre gjatë zhvillimit të censusit të vitit 2011. Bazuar në opinionin e subjekteve të interesuara dhe të autoriteteve të intervistuar, ka disa arsye të ndryshme të cilat përcaktojnë disa persona pa shtetësi në kontekstin Shqiptar ndër të cilat janë:

Një personash të marginalizuar (numër i papërcaktuar kyesisht Rom por jo vetëm) të cilët hasin probleme me regjistrimin civil në përgjithësi dhe me regjistrimin e lindjeve në veçanti. Këta persona vulnerabël dhe të marginalizuar më së shumti kanë mungesa në dokumentacionin e kërkuar nga ligji për sa i takon regjistrimit të vdekjeve, martesave transferimit të vendbanimit të ligjshëm, divorcit, kujdestarisë së fëmijëve etj. Një tjetër grup më i vogël fëmijësh të por-salindur në Shqipëri të cilët rrezikojnë të mbeten pa shtetësi për shkak të faktorëve që lidhen me (i) distancat urbane-rurale (distanca e gjatë nga qendrat shëndetsore, mungesa e mjekëve të specializuar në spitalet rajonale dhe shkaqe të tjera të cilat i kanë detyruar gratë të lindin fëmijët e tyre në kushte shtëpie), (ii) problemet e gjakmarrjes (duke i detyruar shume njerëz dhe antarë të familjeve të tyre të përjashtohen dhe izoloohen nga jeta sociale, kulturore, ekonomike apo administrative e komunitetit), (iii) mungesa e informacionit për procedin e regjistrimit apo arsye të tjera të ngjashme.

Një grup (numër i papërcaktuar) konsiston në popullsinë emigruese Shqiptare (persona të cilët emigrojnë në vende të tjera për shkaqe të ndryshme) dhe arsyeja e mbetjes pa shtetësi lidhet me procedurën e fitimit të shtetësisë së vendit tjetër. Për shembull, një numër emigrantësh të kthyer nga shteti Gjerman e kanë humbur shtetësinë Shqiptare për shkak procesit të aplikimit për shtetësi Gjermane. Një tjetër shembull lidhet me një numër minoritarësh Grek dhe Maqedonas të cilëve ju mungon shtetësia. Pas viteve 2000, se bashku minoritetet Greke dhe Maqedonase vendosën të merrnin dyshtetësi; shumë prej tyre u vendosën në vendet fqinje por disa prej tyre neglizhuan në njëfarë mënyre për të regjistruar veten e tyre apo pasardhësit në vendin tjetër apo në Shqipëri. Ka gjithashtu një grup individësh të cilët e kanë lënë vullnetarisht shtetësinë shqiptare me shpresën për të përfituar të përfituar në ndonjë shtet tjetër, përshembull në Greqi. Ky grup gjithashtu i pidentifikuar njerëzish, e kanë lënë shtetësinë shqiptare me shpresën e përfitimit të drejtave pasurore, përshembull të drejtën për të përfituar pension, bazuar në informacion të gabuar që ata dispononin për legjislacionin e shtetit Grek. Referuar Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme, në Shqipëri në vitin 2011, kishte gjithashtu një grup prej 3000 qytetaresh Shqiptarë të cilët e kanë lënë në mënyrë vullnetare shtetësinë shqiptare në vitet 1990 apo më vonë, për të përfituar një shtetësi të ndryshme, të cilët po përpiqen aktualisht të rifitojnë shtetësinë shqiptare në bazë të ligjit, që lejon dyshtetësinë. Në disa raste, çështjet që i përkasin këtyre personave janë më të komplikuar, duke qënë se disa prej tyre nuk janë regjistruar fare në zyrën e gjendjes civile dhe si pasoje, për të rregulluar statusin e tyre si qytetarë shqiptarë, ata duhet të ndjekin procedurat gjyqësore. Më tej, ka një numër të caktuar qytetarësh të cilët i janë përgjigjur në mënyrë të gabuar pyetsorit të censusit sa i takon shtetësisë së tyre. Censusi shtetëror është metoda e vetme zyrtare për të mbledhur të dhëna për popullsinë, megjithatë censusi në vetvetë nuk përmban një pyetje specifike lidhur me shkaqet e

21 Intervista me E. Gjoleka, A. Mele, H. Gorenca respektivisht, përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët dhe përfaqësues i UNHCR në Shqipëri.

pashtetësisë. Të dhënat për rastet e pashtetësisë dalin nga intervistat dhe konsiderohen si informacione shtesë. Kështu censusi nuk është në gjendje të japë të dhëna të detajuara për personat pa shtetësi që jetojnë në Shqipëri. Asnjë studim shtetëror nuk është iniciuar deri më tani nga burime të tjera për personat pa shtetësi.

Një grup azilkërkuesish, një numër i vogël personash që vijnë nga vende të ndryshme të cilët kanë aplikuar për azil dhe mbrojtje në Shqipëri, bazuar në informacionin e marrë nga autoritetet Shqiptare, janë konsideruar si një aspekt relevant dhe delikat pashtetësisë në Shqipëri. Ligji për azilin, akomodon persona pa shtetësi të cilët kanë një sfond azilkëruesi apo refugjati, sidoqoftë kur historia e tyre është e paqartë, këta persona janë të pambuluar dhe situata e tyre deri diku e paqartë.²²

Referuar ligjit “Per Gjendjen Civile” I ndryshuar²³, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është përgjegjëse për mbajtjen e një regjistri të veçantë për personat pashtetësi si dhe pasqyrimin e vendbanimit të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga informacioni i marrë nga kjo Drejtori, rezulton se personat pa shtetësi regjistrohen në të njëjtin regjister së bashku me personat të cilët e lënë shtetësinë shqiptare, dhe në regjister i vihet statusi “jo aktiv”. Por kjo mënyrë regjistrimi nuk ofron një dallim mes personave të cilët lënë shtetësinë shqiptare dhe si pasojë fitojnë një shtetësi tjetër dhe personave të cilët janë tërësisht pa shtetësi. Si pasojë nuk kemi as të dhëna të sakta të numrit të personave pa shtetësi dhe as arsyt e mbetjes së tyre pa shtetësi.

Po ashtu personat pa shtetësi nuk pajisen më një status të veçantë. Në ligjin “Për të Huajt” parashikohet se personat pa shtetësi duhet të pajisen me një dokument të veçantë udhëtimi²⁴ që i garanton atyre kthimin në territorin e Republikës së Shqipërisë. Por përfundimisht në Ligjin për të huajt nuk përcaktohet se personat pa shtetësi duhet të pajisen me një status të veçantë.

Vlen të thuhet se nga analiza që i bëhet legjislacionit në këtë pikë personat pa shtetësi të cilët kanë lehtësi në procesin e fitimit të shtetësisë shqiptare, janë ata persona të cilët për arsye të ndryshme nuk e kanë fituar shtetësinë e premtuar dhe i është dashur më parë të lënë shtetësinë shqiptare. Për këtë kategori ligji parashikon që duhet të parqesin dokumentacion për rifitimin e shtetësisë shqiptare²⁵. Për personat e tjerë të cilët kanë mbetur pa shtetësi për arsye të ndryshme, ose nuk vërtetohet shtetësia e asnjë shteti, ligji shqiptar nuk parashikon asnjë procedurë të lehtësuar përveç dispozitave të përgjithshme për natyralizimin.

Personat e mitur të cilët kanë lindur në territorin e Shqipërisë dhe nuk mund të fitojnë shtetësi tjetër për shkak të lidhjes amësore apo atësore, veprojnë dispozitat mbi parimin e jus soli, pra në bazë të ligjit ata mund të fitojnë shtetësinë për shkak të lindjes në territorin Shqiptar dhe regjistrohen si fëmijë të gjetur. Nëse një person madhor rregjistrohet në rregjistrat e gjendjes civile me statusin “I gjetur” ai rregjistrohet si person pa shtetësi. Në këto raste ndaj tij, lidhur me shtetësinë, si rregull, veprojnë dispozitat e përgjithshme mbi natyralizimin.

SEKSIONI 4: Regjistrimi i lindjes dhe pashtetësia

4.1 Aksesimi në regjistrimin e lindjeve

Regjistrimi i lindjeve realizohet në bazë të dispozitave të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar. Në Republikën e Shqipërisë numri total i lindjeve për vitin 2014 sipas Instituit të Statistikave ka qënë 3576026.

Dokumenti bazë për vërtetimin e lindjes është certifikata e asistencës në lindje, me të cilën nëna pajiset në maternitet ose në qendrën shëndetsore ku ka lindur. Më pas në bazë të këtij dokumenti bëhet regjistrimi i fëmijës në zyrën e gjendjes civile ku ka banimin personi. Lindja gjithashtu mund të vërtetohet edhe me raport mjekësor ose procesverbal të hartuar në kohën e lindjes, për rastet kur lindja ka ndodhur jashtë institucionit shëndetsor, përshembull në tren, në anije, në avion, në burg ose repart ushtarak.

22 Ligji për Azilin në Republikën e Shqipërisë neni 1/1, 4 dhe 5, shpjegimi i termave azilkërkues dhe refugjat, i disponueshëm në: <http://www.keshilliministrave.al/?fq=brenda&m=news&lid=9453>

23 Ligj nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar nenet 21 dhe 59.

24 Ligj nr. 108/2013 “Për të Huajt”, Neni 16:

Lëshimi i letërnjoftimit dhe dokumentit të udhëtimit për të huajt

“...3. Për qëllime udhëtimi jashtë, autoriteti qendror përgjegjës për kufirin dhe migracionin, sipas kushteve të përcaktuara në konventa ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë, i lëshon një dokument udhëtimi të huajt pa shtetësi, i cili është banor në Republikën e Shqipërisë, duke i dhënë të drejtën të rikthehet në Republikën e Shqipërisë brenda periudhës së vlefshmërisë. Ky dokument është i vlefshëm për një periudhë 2-vjeçare nga data e lëshimit...”.

25 Kreu IV, Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar me ligjin nr. 8442, datë 21.1.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”.

26 <http://www.instat.gov.al/al/themes/popullsia.aspx?tab=tabs-5>

Procesverballi mbahet nga përgjegjësi i mjetit apo institucionit. Në gjitha rastet e tjera, kur personi nuk e provon dot lindjen me dokument, apo dokumenti nuk është në formën e kërkuar, është i detyruar që t’i drejtohet gjykatës për vërtetimin e faktit të lindjes²⁷.

Lindja e fëmijës deklarohet tek nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjestarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi i lindjes mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës me prokurë të posaçme. Ndërsa deklarimi i lindjes për fëmijët e gjetur bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, organi i rendit public në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes²⁸.

Ligji nuk parashikon afat për regjistrimin e lindjes, lindja mund të bëhet në cdo kohë madje për lindjet të cilat regjistrohen Brenda 60 ditëve (lindjet e ndodhura Brenda territorit të Republikës së Shqipërisë) dhe Brenda 90 ditëve (lindjet e ndodhura nga shtetase Shqiptare jashte territorit të republikës së Shqipërisë), nënat përfitojnë një shpërblim monetar²⁹.

Për fëmijet e lindur nga shtetase shqiptare me banim të përhershëm në Shqipëri, jashte territorit të Republikës së Shqipërisë, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare në vendin ku ka lindur fëmija dhe nëse kjo gjë nuk është e mundur atëherë regjistrimi i lindjes bëhet edhe në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi.

Ne Republikën e Shqipërisë ka patur ndër vite mungese aksesit në regjistrimin civil, për shkakë të ndryshme. Në këtë kuadër janë bërë vazhdimisht përmirësime në legjislacion për të arritur në situtën ku jemi. Por edhe aktualisht ka disa kategori të cilët e kanë të vështirë aksesin në regjistrimin civil. Fëmijët e lindur nga azilkërkues ose nga refugjatët ne Republikën e Shqipërisë mund të regjistrohen. Ata regjistrohen në regjistrin themeltar të shtetasve në Zyrën e Gjendjes Civile ku janë të regjistruar edhe prindërit e tyre dhe fitojnë shtetësinë shqiptare menjëherë nëse prindërit e tyre janë rezidentë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë. E njëjta gjë vlen edhe për viktimat e trafikimit, fëmijët e lindur prej tyre i nënshtrohen rregullave të përgjithshme të fitimit të shtetësisë shqiptare, pra ata e fitojnë atë vetiu nëse kanë lindur në territotin e republikës së shqipërisë dhe prindërit janë rezidentë të ligjshëm, por duhet theksuar se viktimat e trafikimit nuk konsiderohen një kategori e veçantë në rregullat përgjithshme të fitimit të shtetësisë.

Ligji “Për Shtetësinë Shqiptare”, parashikon që shtetësia mund të fitohet vetiu nga një fëmijë që lind në territorin shqiptar, por njëkohësisht këtë parashikim e lidh me rezidencën e ligjshme të prindërve³⁰, pra duhet thënë se parimi i ius solis kushtezohet në këtë rast me rezidencën e ligjshme të prindërve, duke nënkuptuar një leje të vlefshme qëndrimi të përfituar nga autoritetet përkatëse. Pra përfundimisht mund të dedukojmë që një fëmijë i cili lind në territorin shqiptar nga prindër me shtetësi të huaj dhe që nuk janë rezidentë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë nuk e fiton shtetësinë shqiptare, por si rregull kjo nuk e pengon atë të regjistrohet.

Fëmijët e braktisur ose thënë ndryshe, fëmijët të cilët lindin nga një nënë që identifikohet por që deklarohet që do ta braktisë fëmijën ose që jep vullnet për birësimin e tij, regjistrohen në zyrën e gjndes civile që mubulon qendrën shëndetsore ku ka ndodhur lindja. Fëmija në kë rast regjistrohet me të dhënat e deklaruar nga nëna në bazë të dokumentit të identifikimit të saj dhe sistemohet në një qendër rezidenciale për fëmijë, nga ku dhe fillojnë sipas rastit procedurat për birësimin e fëmijës ose vendosjes në kujdestari.

Është një fakt hendeku i krijuar mes numrave mbi lindjet e ndodhura të provuara përmes certifikatave të asistencave në lindje në Maternitete dhe numrit të lindjeve të regjistruara në zyrën e gjendjes civile. Kjo do të thotë se numri i regjistrimit të lindjeve të raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (numër i cili është i njëjtë me atë që jepet edhe nga INSTAT) është më i vogël se numri i raportuar nga Departamenti i Statistikave në Ministrinë e Shëndetësisë I cili mer të dhëna nga Matrenitetet apo Qendrat Shëndetsore³¹. Por, duke patur në konsideratë që në zyrat e gjendjes civile ka gjithashtu të regjistruar fëmijë

27 Neni 38 i Ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar.
28 Neni 40 i Ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar.
29 Neni 41 i Ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për Gjendjen Civile” i ndryshuar.
30 Neni 8 Ligji nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare” i ndryshuar me ligjin nr. 8442, datë 21.1.1999 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998 “Për Shtetësinë Shqiptare”, “....2. Një fëmijë i lindur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga prindër me shtetësi tjetër, të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të marrë shtetësinë shqiptare me pëlqimin e të dy prindërve”.
31 Bazuar në studimin e vizibilitetit për nevojën e vendosjes së sistemit elektronik të regjistrimit të lindjeve, i bërë nga TLAS në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Ministrinë e Shëndetësisë në 2013, u gjet se dallimi ndërmjet numrit të lindjeve të raportuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe numrit të lindjeve të regjistruara nga zyrat e gjendjes civile në të njëjtin vit, është pothuaj 10% (më i vogël se ai i raportuar nga Ministria e Shëndetësisë).

të cilët kanë lindur jashtë institucioneve³², mund të arrijmë në konkuzionin se diferenca është edhe më e madhe bazuar në një deduksion të thjeshtë aritmetik, që do të thotë që duhet një analizë më e thelluar.

Megjithatë sikurëse u përmend më sipër ligji “Për Gjendjen Civile” gjithashtu e ka parashikuar vëmendjen dhe rëndësinë e raportimit të lindjeve kur thotë: “Të gjitha qendrat shëndetsore, publike apo private të cilat janë të autorizuar për të verifikuar lindjet, janë të detyruara të dërgojnë çdo të hënë në zyrat e gjendjes civile ku prindërit kanë vendbanimin, informacion për lindjet që kanë ndodhur në institucion. Moszbatimi i këtij parashikimi dënohet me gjobë të barabartë me 50 000 lekë”. Ministria e Shëndetsisë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë për raportim në bazë të ligjit “Për Gjendjen Civile” dhe po ashtu Ministria e Brendshme nuk e ka aplikuar deri më tani gjobën që parashikohet prej ligjit të sipërcituar.

Probleme me regjistrimin civil kanë gjithashtu dy kategori të veçanta personash.

Se pari, fëmijët të cilët kanë lindur jashtë territorit të republikës së Shqipërisë nga prindër shqiptarë por të cilët kanë deklaruar të dhëna të pasakta për identitetin e tyre. Pas kthimit në Republikën e Shqipërisë është e pamundur të behët regjistrimi i lindjes së fëmijës për shkak se nuk përputhen të dhënat e deklaruara të prindërve me të dhënat e tyre të vërteta. Në këtë rast fëmja është e pamundur të regjistrohet si shtetas shqiptar, dhe në shtetin ku ka lindur mund të jetë i regjistruar dhe ta ketë marrë shtetësinë por figuron me të dhëna të rreme për prindërit. Kjo sjell dy probleme, së pari që fëmija rrezikon një identitet të dyfishtë dhe së dyti që fëmija të mbësë pa shtetësi pasi rregullat e fitimit të shtetësisë ndryshojnë nga vendi në vend.

Se dyti, përkon me një kategori të vecantë fëmijësh të cilët kanë lindur nga shtetas Shqiptarë emigrantë në territorin e Republikës së Greqisë. Kjo kategori i ka lindur fëmijët dhe ata janë regjistruar në zyrën e gjendjes civile të vendit të huaj pa emër për fëmijën por akti i lindjes i përmban të sakta të gjitha të dhënat e tjera përfshirë edhe identitetin e prindërve. Shërbimi shqiptar i Gjendjes Civile nuk e njeh aktin e lindjes së shtetit të huaj i cili nuk ka të dhëna për emrin e fëmijës dhe refuzon të bëjë regjistrimin e tij dhe si pasojë fëmija mbetet pa u regjistruar dhe pa e fituar shtetësinë shqiptare. Një çështje e tillë është ndjekur në rrugë gjyqësore nga avokatët e TLAS dhe pritet të gjendet një zgjidhje gjyqësore.

4.2 Lidhja mes regjistrimit të lindjes dhe shtetësisë

Regjistrimi i lindjes është parakusht i domosdoshëm për t’u pajisur me shtetësi pasi shtetësia përbën një nga elementët e identitetit në regjistrimin e individëve.

Në certifikatën e asistencës së lindjes nuk shënohet shtetësia e nënës, por ajo duhet të identifikohet nëpërmjet dokumentit të saj të identifikimit. Në momentin që bëhet deklarimi i lindjes pranë nëpunësit të gjendjes civile, verifikohet edhe shtetësia e nënës e po ashtu nëse nënë apo prindërit që e kanë lindur janë rezidentë të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë.

Sikurëse u përmend më sipër, ka raste ku fëmijë të cilët duhet ta fitojnë shtetësinë shqiptare për shkak se kanë lindur nga shtetas shqiptarë por regjistrimi nuk mund të kryehet, si pasojë ato nuk e fitojnë dot shtetësinë shqiptare.

³² Bazuar në studimin e vizibilitetit për nevojën e vendosjes së sistemit elektronik të regjistrimit të lindjeve, i bërë nga TLAS në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Ministrinë e Shëndetsisë në 2013, u gjet një numër total prej 35,012 fëmijë të lindur përgjatë 2012; 34,759 prej tyre ishin lindur në maternitet dhe 217 fëmijë ishin lindur jashtë maternitetit. Shifrat ekzistuese të fëmijëve të paregjistruar tregojnë se ka akoma fëmijë të cilët kanë lindur dhe nuk janë raportuar në regjistrat e gjendjes civile.

KONKLUZIONE

Pashtetësia nuk konsiderohet ende një çështje në vend.

Në këtë kontekst duhet të ketë një dallim të qartë mes regjistrimit civil dhe pashtetësisë në mënyrë që të kuptohet edhe nga autoritetet relevante.

Nuk ka në fuqi një status për personat pa shtetësi. Për më tepër nuk ka një ligj specifik për pashtetësinë po ashtu nuk ka as një kuadër ligjor të përshtatshëm për pashtetësinë. Një ligj specifik për pashtetësinë do të kontribuonte në një kuadër ligjor të përshtatshëm edhe pse Konventa për statusin e personave pa shtetësi është miratuar.

Boshllëqet në përfitimin e dokumentave të identifikimit dhe të shërbimeve mund të shkaktohet edhe si rezultat i mungesës së shtetësisë. Personat pa shtetësi në vend duhet të preken po ashtu nga mungesa e dokumentave të identifikimit.

Edhe pse Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile janë autoritetet përkatëse që meren me procedurat e fitimit të shtetësisë, ato nuk luajnë një rol të rëndësishëm për parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë si dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave pa shtetësi.

Shqipëria ende nuk e ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës për “Shmangien e e Pashtetësisë në Kontekstin e Zhvillimit Shtetëror 19.05.2006”.

Personat pa shtetësi nuk identifikohen personalisht dhe sistematikisht. Identifikimi i tyre behet vetëm mbi bazë vullnetare dhe ata mund të mbetën pa shtetësi për një kohë të gjatë.

Bazuar në ligj, Zyrat e Gjendjes Civile dhe Policia e Shtetit duhet të identifikojnë të gjithë personat (shtetast shqiptarë, shtetasit e huaj rezidentë të ligjshëm, shtetasit të cilët kanë patur më parë shtetësinë shqiptare por që kanë hequr dorë prej saj dhe personat pa shtetësi) të cilët jetojnë në zonat e tyre të përgjegjësisë dhe t’i regjistrojnë ata në regjistrat e gjendjes civile.

Mungesa e një ligji për pashtetësinë në Shqipëri, krijon boshllëqe ligjore për personat pa shtetësi për të qendruar ligjerisht (të ligjshëm) në vend. Kjo ndikon më së shumti aksesin në shërbime të personave pa shtetësi. Ata trajtohen kryesisht si grupe vulnerabël nga projektet e shoqërisë civile.

Censusi i popullsisë nuk është në gjendje të japë të dhëna të detajuara për personat pa shtetësi që jetojnë në vend. Asnje studim tjetër shtetëror nuk është ndërmarrë deri më tani nga burime të tjera për personat pa shtetësi. Po ashtu ka mungese të dhënash të detajuara mbi numrin dhe arsyet e mbetjes pa shtetësi.

Për shkak të mungesës së një strategjie zyrtare dhe kuadri ligjor për personat pa shtetësi, nuk është hartuar dhe elaboruar një profil socio-ekonomik bazuar në moshën, seksin, besimin fetar etj.

TLAS, 2015

ANNEX 2: Studim rasti

Pseudonimi: Vasil
Mosha: 25 vjeç
Seksi: Mashkull
Vendi i origjinës: Shqipëri
Qyteti i qendrimit aktualisht: Fier
Shteti i qendrimit aktualisht: Shqipëria
Data e mbërritjes: Lindur në Shqipëri
Statusi i migrimit: Shtetas Shqiptar
Arsyet pse është pa shtetësi: Shiko përshkrimin çështjes

Përshkrim i shkurtër: Vasili është shtetas Shqiptar i lindur nga dy prindër Shqiptarë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Familja e Vasilit (gjyshi i tij, babai dhe pjestarët e tjerë të familjes) në vitin 1990, ndërsa Vasili ishte ende i porsalindur, emigruan në shtetin Grek si emigrantë ekonomikë për një jetë më të mire. Pasi ndenjën disa kohë në shtetin e huaj, morën vesh se po të linin shtetësinë shqiptare do të fitonin shtetësinë Greke. Në këto kushte gjyshi i Vasilit aplikon në emër të familjes për lënien e shtetësisë shqiptare. Pas disa procedurave, me dekret të Presidentit bëhet e mundur lënia e shtetësisë shqiptare për të gjithë pjestarët madhorë dhe të gjithë të miturit e familjes, ndër këta edhe Vasili. Pas lënies së shtetësisë shqiptare, për arsye të paqarta asnjë pjestar i familjes nuk e fitoi kurrë shtetësinë Greke. Në këto kushte të gjithë pjestarët e familjes mbetën pa shtetësi. Pas disa kohësh ata u kthyen sërish në shtetin shqiptar ku dhe jetojnë aktualisht. Djemtë e familjes emigronin me periudha të shkurtra për të punuar në shtetin Grek për të siguruar të ardhura për familjen. Kalimi i kufirit realizohej gjithmonë në mënyrë ilegale, pasi nuk dispononin dokumenta identifikimi.

Pas një periudhe relativisht të gjatë TLAS u vu në dijeni të këtij problemi pas një takimi me komunitetin ku jetonte Vasili. Ky problem nuk ishte referuar asnjëherë duke qënë se deri në atë moment vetë personat nuk e kishin kuptuar që ishin pa shtetësi. Ata mendonin se nuk kishin një dokument identifikimi për shkak se ata nuk kishin mundësi të paguanin për të përfituar pashaportën ose kartën e identitetit. Pas një verifikimi të situatës u konstatua gjendja e përshkruar më sipër. Tashmë, Vasili ishte “martuar” dhe kishte sjellë në jetë një fëmijë. Fëmija ishte i paregjistruar edhe pse nëna e tij ishte shtetase shqiptare dhe e regjistruar. Ajo jetonte në një zonë të largët të shqipërisë dhe e kishte të pamundur për arsye ekonomike të udhëtonte dhe të bënte regjistrimin e fëmijës, në këto kushte fëmija ishte i paregjistruar dhe si pasojë pa shtetësi.

Menjëherë pas konstatimit të situatës TLAS përgatiti të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të gjithë personat e familjes për të aplikuar për rifitimin e shtetësisë shqiptare. Kjo procedure është e komplikuar pasi kërkon një numër të madh dokumentash dhe po ashtu kosto ekonomike, procedura të cilat personat e kësaj familje nuk mund t’i ndiqnin vetë, siç e provon edhe fakti se kishin jetuar për vite të tëra në një situatë të tillë. Pas rreth një periudhe një vjeçare personat e rifituan shtetësinë shqiptare dhe u pajisën me dokument identifikimi. Po ashtu edhe Panajoti u pajis me kartën e identitetit dhe u bë i mundur regjistrimi i djalit të tij në zyrën e gjendjes civile. Gjithashtu ai mundi të lidhte martesën ligjore me nënën e fëmijës së tij. Fëmija mundi të ketë akses në institucionet shëndetsore për të kryer vaksinat, po ashtu të regjistrohet në kopësht.

Kjo situatë nuk i përket vetëm Vasilit dhe familjes së tij. Në situatën e tyre ndodhen edhe persona të tjerë të cilët i përkasin të njëjtit komunitet dhe që aktualisht janë të emigruar në shtetin Grek ose gjetkë¹.

Shprehje: *I ngjashëm me personat e tjerë pa shtetësi në Shqipëri, Vasili kishte vështirësi që të siguronte akses fizikisht për nevojat e tij në ushqim apo ndihmë financiare. Veçanërisht për kryefamiljarët të cilëve u mungojnë kualifikimet, siç janë zakonisht anëtarët e komunitetit Rom, akses në programet sociale apo ndihmë ekonomike për të siguruar nevojat më bazike, është edhe më e vështirë. Për shkak të mungesës së një ligji për pashtetësinë, Vasili dhe familja e tij, nuk kishin akses në ndihmë ekonomike apo programe të tjera sociale që ofron shteti. Pas rifitimit të shtetësisë shqiptare, Familja e Vasilit duke përfshirë edhe fëmijën e tij, u kualifikuan për të aksesuar shërbime të tjera të vazhdueshme apo shërbime shëndetsore, akses në kopshte dhe shkolla, akses për të aplikuar si i pastrehë, të drejtën për t’u punësuar, të drejtën për të përftuar të gjitha dokumentet e nevojshme për të patur akses në shërbimet publike.*

Gjuhët: Shqip, Romisht.

1 Në rast se prindërit nuk janë rezidentë të ligjshëm në një vend, ose nëse ata nuk posedojnë dokumenta të vlefshme identifikimi, ata nuk mund t’i regjistrojnë fëmijët e tyre, dhe kjo çon në një situatë pashtetësie. Regjistrimi i lindjes mund të askesohet fizikisht nga e gjithë popullsia, por ky process nuk është i lehtësuar nga regjistrimi automatik që në spital apo nga mamitë, i cili do të minimizonte çështjet e fëmijëve/shtetasve të paregjistruar. Duhet theksuar se shtetësia e një fëmije në regjistrin e lindjes varet nga dokumentacioni që paraqet prindi (çertifikatë lindje, kartë identiteti dhe pashaportë).

Pseudonimi: Ilir
Mosha: 36 Vjeç
Seksi: Mashkull
Vendi i origjinës: Shqipëri
Qyteti i qendrimit aktualisht: Elbasan
Shteti i qendrimit aktualisht: Shqipëria
Data e mbërritjes: Lindur në Shqipëri
Statusi i migrimit: Shtetas Shqiptar
Arsyet pse është pa shtetësi: Shiko përshkrimin çështjes

Përshkrim i shkurtër: Iliri është shtetas Shqiptar. Ai është i martuar dhe ka një fëmijë të seksit mashkull i moshës 4 vjeçare. Për shumë vite ka qenë emigrant në shtetin Grek, atje ka lindur edhe fëmija i tij. Në momentin e lindjes, fëmijës nuk i është caktuar emri nga prindërit e tij, por ai është pajisur me dokumentin e lindjes i cili përmban edhe të dhëna të sakta për identitetin e prindërve. Më pas Iliri ka bërë normalisht regjistrimin e lindjes së fëmijës në zyrën e gjendjes civile të shtetit të huaj. Më pas për arsye të caktuara Iliri së bashku me familjen e tij është kthyer në shtetin Shqiptar. Arsyet të cilat e larguan atë nga shteti Grek nuk i japin të drejtë që të shkelë më në atë shtet. Mirëpo me kthimin në Shqipëri, Iliri u përball me problemin e fëmijës së mitur i cili nuk ishte i regjistruar si shtetas shqiptar. Për të bërë regjistrimin e tij ishte i nevojshëm akti i lindjes i legalizuar sipas kushteve të përcaktuara të aktet ndërkombëtare për vlefshmërinë e dokumentave të huaja. Në këto kushte Iliri kërkoi ndihmë për regjistrimin e fëmijës së tij, i cili për shkak të mungesës së aksesit në regjistrimin civil dhe shtetësinë shqiptare i mohoheshin një sërë të drejtash dhe shërbimesh.

Në këto kushte nëpërmjet TLAS dhe Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë u arrit të sigurohej një kopje e legalizuar e aktit të lindjes për fëmijën. Më pas ky akt u dërgua për t’u regjistruar pranë zyrës së gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile mohon regjistrimin e fëmijës me argumentin se mungon emri i fëmijës. Sipas asaj që orienton shteti shqiptar², Iliri duhet të paraqitet personalisht në zyrën e gjendjes civile të shtetit të huaj t’i vendosë një emër fëmijës e më pas fëmija mund të regjistrohet dhe të fitojë shtetësinë shqiptare. Mirëpo në rastin e Ilirit kjo gjë është e pamundur pasi ai nuk mund të shkelë në territorin e shtetit Grek. Në të njëjtën situatë ndodhën edhe shumë familje të tjera të cilët i kanë aktualisht fëmijët të paregjistruar dhe për arsye të ndryshme (qofte dhe thjesht ekonomike) nuk mund të udhëtojnë në shtetin e huaj. Sipas një interpretimi të ligjit shqiptar për Gjendjen Civile, emri është një e dhënë e ndryshueshme e cila kur fëmija është ende i mitur mund të ndryshohet me marrëveshje të prindërve. I njëjti parim duhet të zbatohet edhe në këtë rast, ku fëmijës nuk duhet t’i mohohet e drejta për t’u regjistruar dhe për të fituar shtetësia shqiptare³.

Kjo çështje është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, ndërkohë Iliri paraqet shqetësim dhe deklaron se fëmija i tij nuk mund të shkojë në kopësht dhe as të ketë akses në institucionet shëndetsore.

Shprehje: *Numri i fëmijëve të paregjistruar apo pashtetësi si në situatën e Ilirit është i madh. TLAS ka identifikuar më shumë se 200 raste të tilla dhe ka pasqyruar edhe shumë të tjera të paidentifikuara. Çështja e Ilirit është një çështje strategjike shumë e rëndësishme. Zgjidhja e kësaj çështje nëpërmjet procedurës gjyqësore do të thotë se fëmijë të tjerë në të njëjtën situatë do të kenë një precedent tek i cili mund të bazohen, bazuar në vendimin përfundimtar të gjykatës të cilin Zyrat e Gjendjes Civile janë të detyruara ta zbatojnë. Të gjithë këta fëmijë që i përkasin komunitetit Rom dhe jo vetëm, u mungon aksesi në shërbime sociale kryesore për shkak të mungesës së shtetësisë dhe mosidentifikimit në regjistrin Kombëtar të shtetasve. Zgjidhja e përkohshme e facilituar nga TLAS si një ofrues i ndihmës ligjore, konsiston në pajisjen e djalit të Ilirit me një dokument që justifikon të qenurit në një procedurë gjyqësore, e që i mundëson atij paraqitjen në organet shtetërore për të mundësuar aksesin në shërbime të caktuara përkohësisht deri sa procedura gjyqësore të përfundojë. Kjo letër apo dokument është pranuar nga autoritetet kompetente deri sa procedura gjyqësore vazhdon dhe për sa kohë është lëshuar bazuar në planin strategjik i aprovuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë që daton në mars 2015 e që prek kryesisht minoritetin Rom dhe egjiptian.*

Gjuhët: Shqip.

² Regjistrimi i lindjes është i lidhur me fitimin e shtetësisë që në lindje për shkak të prejardhjes dhe autoriteti kompetent për këtë regjistrim është Zyra e Gjendjes Civile. Ligji për shtetësinë Shqiptare dhe ligji për Gjendjen Civile përcaktojnë procedurën se si një i porsalindur regjistrohet. Nëse një fëmijë nuk është i regjistruar në Zyrën e Gjendjes civile dhe në Regjistrin kombëtar të Shtetasve, ai ose ajo nuk identifikohet si qenie njerëzore dhe si pasojë nuk konsiderohet shtetas shqiptar, ai ose ajo është pa shtetësi. Kërkesat për regjistrimin civil janë të mirëpërcaktuara në ligj dhe të impleментuar nga organet administrative. Zyrat e Gjendjes Civile të vendosura në qytete dhe fshatra, janë përgjegjëse për identifikimin dhe regjistrimin e popullsisë që jeton në zonat e tyre. Këto zyra ofrojnë gjithashtu shërbime të tjera përveç regjistrimit civil.

³ Mungesa e dokumentacionit të kërkuar për të aplikuar për regjistrimin e lindjeve është një çështje shumë serioze dhe një barrierë për shumë familje vulnerabël dhe fëmijët e tyre e cila çon në pashtetësi. Procedurat ndiqen shpesh herë Brenda një kohe jo të arsyeshme dhe janë shpesh herë jotë përballeshme ekonomikisht për shumë persona vulnerabël (shpenzimet procedurale përfshijnë taksa dhe tarifa vendore, shpenzime gjyqësore nëse çështja përfaqësohet në gjykatë, procedura të tjera të ndërmjetme, etj). Për më tepër, personat pa shtetësi dhe fëmijët nga komunitetet vulnerabël janë shpesh herë subject diskriminimi, i cili gjithashtu ndikon në situata pashtetësie.

Pseudonimi: Blerina
Mosha: 26 Vjeç
Seksi: Femër
Vendi i origjinës: Shqipëri
Qyteti i qendrimit aktualisht: Fier
Shteti i qendrimit aktualisht: Shqipëria
Data e mbërritjes: Lindur në Shqipëri
Statusi i migrimit: Shtetase Shqiptar
Arsyet pse është pa shtetësi: Shiko përshkrimin çështjes

Përshkrim i shkurtër: Blerina është shtetase shqiptare. Ajo flet shumë pak shqip duke qënë se emigroi në shtetin Grek në një moshë shumë të re. Kur ishte pothuajse 13 vjeç, ajo bashkejetonte me një burrë në Greqi dhe ajo e konsideronte se “ishte e martuar”. Në fakt ajo në atë kohë ishte minorene dhe referuar legjislacionit shqiptarajo nuk mund të martohej ligjërisht në atë moshë duke qënë se martesë është e lejueshme pas mbushjes së moshës 18 vjeçare. Ndërkohe që jetonte me bashkëjetuesin e saj, Blerina solli në jetë tre fëmijë edhe pse vetë ishte ende në moshë mjaft të re. Fëmijët lindën në një qendër shëndetsore në Greqi. Në një kohë të caktuar të jetës së saj, Blerina i jep fund marrëdhënies me bashkëjetuesin e saj dhe u kthye në Shqipëri bashkë me tre fëmijët e saj për të jetuar me Prindërit e saj në Fier. Babai i fëmijëve nuk tregoi asnjë interes të veçantë për fëmijët për një kohë të gjatë dhe gjithashtu nuk kontribuonte ekonomikisht në mirëritjen e tyre.

Pas kthimit të saj në Shqipëri, Blerina nuk mund të regjistronte tre fëmijët e saj në zyrën e Gjendjes Civile në Fier, sepse ajo nuk kishte sjelle nga Greqia dokumenta për asnjë nga fëmijet të cilat mund të ishin lëshuar nga qendra spitalore ku kishin lindur fëmijët⁴.

Blerina si shumë gra të tjera Shqiptare, l mungonin mjetet financiare për të paguar tarifën përkatëse spitalore e kërkuar nga spitalet Greke ku ajo kishte lindur fëmijët e saj. Ajo në këto kushte u largua nga apitali pa paguar tarifën dhe pa u pajisur me dokumentacionin përkatës si lindjeve. Rrjedhimisht fëmijët e Blerinës nuk mund të regjistroheshin në zyrën e gjendjes civile në Fier, duke mbetur kështu të paregjistruar dhe pashtetësi. Si pasojë edhe Blerina nuk njihej ligjërisht si një nënë e vetme. Statusi i saj në Gjendjen Civile kishte mbetur i pandryshuar dhe ajo tregohet si beqare dhe nuk njihej si kryefamiljare e tre të miturve. Kjo situatë e bënë Blerinën të paaftë për të patur akses në programet socilae. Familjarët e Blerinës kanë kërkuar ndihmë në mënyrë të vazhdueshme nga autoritetet vendore përkatëse sepse fëmijët e paregjistruar nuk mund të vaksinoheshin, nuk mund të regjistroheshin në shkolla e kopshte, nuk njiheshin në zyrën e ndihmës ekonomike etj. Këta fëmijë të cilët janë të paregjistruar që nga lindja në zyrën e gjendjes civile, janë të panjohur përpara ligjit, për ta nuk ka as gjurme të dokumentuar për lindjen apo vdekjen, ata thjesht konsiderohen sikur nuk ekzistojnë. Në rastin e Blerinës, asnjë përfaqësues i autoriteteve lokale nuk ofronte ndonjë asistencë në lidhje me këta tre fëmijë të paregjistruar. Çështja mund të ndiqej vetëm me procedurë gjyqësore. Nëpërmjet gjykimit civil u bë e mundur që të regjistroheshin vetm dy nga fëmijët e Blerinës. Përgjatë procedurave gjyqësore, papritur, babai i fëmijëve u kthye në Shqipëri dhe pa vullnetin e Blerinës mori me vete ne Greqi në mënyrë të paligjshme djalin e madh. Ai fëmijë është ende i paregjistruar, i paidentifikuar, i padukshëm e pa shtetësi⁵.


Shprehje: Pas procedurave gjyqësore, dy prej fëmijëve të Blerinës u regjistruan dhe si pasojë fituan shtetësinë shqiptare. Referuar atyre që thote Blerina, shqetësimi i saj më i madh është se fëmijët e saj janë të ndarë. Ajo mendon që është normale që ish-bashkëjetuesi i saj e njëkohësisht babai i fëmijëve, të mbajë njërin prej fëmijëve, por ajo mendon që fillimisht fëmija duhet të regjistrohet në Zyrën e Gjendjes Civile. Blerina gjithashtu uron të ketë mundësinë të komunikojë të takojë dhe të flasë me djalin e saj. Duhet të theksohet se prindër vulnerabël si Blerina shpesh herë nuk janë të ndërgjegjësuar plotësisht për rrezikun dhe barrierat që femija i saj i paregjistruar mund të përballet si dhe faktit se si pasojë e mungesës së shtetësisë mund të mos i njihen të drejtat e njeriut.

Gjuhët: Shqip, Romisht.

4 Gra të varfra Shqiptare, veçanërisht nga komuniteti rom, që jetojnë si emigrante në Greqi, tipikisht l lindin fëmijët në spitalet Greke, por ato nuk kanë mundësi të paguajnë tarifat spitalore të cilat janë tëpër të larta për to. Kjo kategori zakonisht largohen nga spitali në mënyrë të fshehtë pa bërë ndonjë pagesë dhe pa u pajisur me dokumentacionin e nevojshëm të lindjes l cili normalisht lëshohet nga spitali e i cili mund të përdoret më pas si provë që përmban të gjitha të dhënat për nënën e për fëmijën, e cili më pas paraqitet në zyrën e gjendjes civile përkatëse.

5 Zakonisht fëmijët e paregjistruar janë më vulnerabël dhe të ekspozuar ndaj dhunës në familje dhe të tjera formave të dhunës, viktimat të trafikimit, punës së detyruar dhe shume formave të tjera të abuzimit. Në Shqipëri, ka shumë çështje të identifikuara të prindërve apo të afërmve, apo të tjerë, të cilët kanë trafikuar, shitur e abuzuar këta fëmijë por nuk ka të dhëna të dokumentuara të cilat mund të gjenden për të cilat mund të hapet një çështje gjyqësore.





Asnjë fëmijë nuk zgjedh të mbesë pa shtetësi. Është një e vërtetë e pamohueshme që çdo fëmijë i përket kësaj Bote, një vendi, një komuniteti dhe kjo duhet të njihet përmes gëzimit të të drejtës për të patur një shtetësi. Pashtetësia vazhdon të ekzistojë për shkak se shtetet Europiane po dështojnë që të sigurojnë që të gjithë fëmijët që lindin Brenda kufijve Europianë ose nga prindër Europianë të fitojnë një shtetësi. Rrjeti European për Pashtetësinë (ENS) advokon si një nga parimet e tij themelore që asnjë fëmijë i Europës nuk duhet të jetojë pa patur një shtetësi.

Ky punim është njëri nga të shumtët që është draftuar në kuadër të fushatës së ENS, e shpallur në Nëntor 2014, "Asnjë Fëmijë i Europës nuk duhet të jetë pa shtetësi". Ai ekzaminon praninë apo mungesën, përmbajtjen dhe implementimin e masave mbrojtëse ligjore për parandalimin e pashtetësisë së fëmijëve në nivel shtetëror. Punimet janë pregatitur po ashtu nga sejcili prej antarëve të ENS në Estoni, Itali, Lituan, Maqedoni, Poloni, Ruman dhe Slloveni – si pjesë e një qasje të koordinuar duke patur një metodologji kërkimore të njëjtë.

Sejcili nga studimet përmban: një analizë të detajuar ligjore duke përfshirë edhe urdhrat, masat apo rregulloret relevante; identifikimin dhe analizimin e jurisprudencës; të dhëna nga intervistat me autoritetet implementuese, juristë dhe të tjerë ofrues shërbimesh lidhur me njohuritë e tyre sa i takon masave mbrojtëse, po ashtu me organizatat me qasje advokuese rreth kësaj çështje. Çdo studim gjithashtu përmban një numër çështjesh studimore për të theksuar problemet e identifikuar.



*"None of Europe's children
should be stateless"*



European
Network on
Statelessness